



TURISTË TË VARFËR, NDIKIM I ULËT NË EKONOMINË SHQIPTARE

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2024



AUTOR
ILIR BRASHA

QENDRESA QYTETARE

NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBAJTJA:

HYRJE.....	3
NUMRI I TURISTËVE NDËR VITE	4
SHPENZIMET E TURISTËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI.....	4
SHPENZIMET E SHQIPTARËVE SI TURISTË JASHTË VENDIT.....	5
TË ARDHURAT NETO NGA TURIZMI.....	6
NETË QËNDRIMET NË SHQIPËRI NGA JO-REZIDENTËT.....	6
NUMRI MESATAR I NETË QËNDRIMEVE NË SHQIPËRI NGA JO-REZIDENTËT	7
TURIZMI NË SHQIPËRI SIPAS QËLLIMIT TË UDHËTIMIT.....	8
TURISTËT SIPAS ORIGJINËS	9
NUMRI I TURISTËVE PËRJASHTUAR VENDET FQINJE	10
SHPENZIME MESATARE PËR TURIST TË HUAJ NË SHQIPËRI	11
SHPENZIME DITORE MESATARE TË NJË TURISTI TË HUAJ NË SHQIPËRI.....	12
SHPENZIMET MESATARE TË SHQIPTARËVE SI TURISTË JASHTË VENDIT	14
MODEL EKONOMETRIKO/STATISTIKOR: NDIKIMI I TURIZMIT NË EKONOMI.....	15
GJETJET KRYESORE	18
REKOMANDIME.....	20
REFERENCA	2

HYRJE

Turizmi është një nga nënsektorët më të rëndësishëm për ekonominë shqiptare dhe që po merr gjithnjë e më shumë vëmendje. Numri i turistëve dhe imazhi që po i jepet turizmit, sidomos pas vitit 2021, ka bërë që Turizmi të jetë një nga promotorët e rritjes ekonomike në vitet e pas-Covidit.

Ky punim ka për qëllim që të sjellë disa të dhëna dhe rezultate mbi turizmin duke u ndalur që tek numri i turistëve që vijnë në Shqipëri, duke analizuar origjinën e tyre, duke analizuar gjithashtu netë qëndrimet e tyre, si dhe duke llogaritur edhe shpenzimet për një person që vjen në Shqipëri. Llogaritjet janë bërë duke u bazuar në të dhëna që disponohen në databazën e INSTAT dhe atë të Bankës së Shqipërisë. Duke shikuar të gjithë këta indikatorë së bashku mund të konkludojmë edhe një mendim se si është ecuria reale e Turizmit në Shqipëri dhe ku qëndrojnë edhe disa nga çështjet që duhet të fokusohemi në të ardhmen.


Rezultatet tregojnë që shpenzimet mesatare të një turisti në Shqipëri për vitin 2023 kanë qenë 411 euro përgjatë gjithë qëndrimit të tij, me një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitin 2022, por kur krahasohet me vitet 2008-2010 vihet re një rënie e shpenzimeve mesatare të turistëve. Në pamje të parë niveli i shpenzimeve mesatare na tregon që turistët që vijnë në Shqipëri nuk shpenzojnë shumë, por në fakt problemi i shpenzimeve të tyre lidhet me kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në Shqipëri. Përkatësisht, netë qëndrimet mesatare të një jo-rezidenti në Shqipëri përgjatë vitit 2023 ishin 2.58 netë. Pra, një turist ka shpenzuar mesatarisht 2.58 netë në Shqipëri përgjatë vitit 2023, duke shpenzuar mesatarisht në ditë rreth 160 euro.

Për më tepër modeli i ndërtuar në këtë punim, tregon që një rritje e turizmit me 10% (numrit të tyre) do të sillte një rritje me 0.69% të PBB-së.

NUMRI I TURISTËVE NDËR VITE

Numri i turistëve ka ardhur në rritje të vazhdueshme përgjatë viteve me përjashtim të dy viteve në të cilat është shënuar rritje negative, përkatësisht në vitin 2013 dhe vitin 2020. Në vitin 2022 numri i turistëve është rritur me 33% krahasuar me vitin 2021. Po ashtu rritje dyshifrore është shënuar edhe më vitin 2023, përkatësisht 35% më shumë turistë të huaj kanë mbërritur në Shqipëri krahasuar me vitin 2022. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2023 Shqipërinë e kanë vizituar 58.5% më shumë turistë të huaj.

Grafiku 1: Numri i Turistëve të huaj në Shqipëri, 2022-2023




Burimi: INSTAT

SHPENZIMET E TURISTËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI

Në rastin kur shikojmë shpenzimet e të huajve në Shqipëri, rezulton që në vitin 2023 të huajt kanë shpenzuar 4.17 milionë euro në Shqipëri, ose rreth 47% më shumë sesa në vitin 2022. Në vitin 2022, shpenzimet e të huajve në Shqipëri ishin 2.84 milionë euro, ose 48.5% më shumë sesa në vitin 2021. Krahasuar me vitin 2019, shpenzimet e të huajve në Shqipëri për vitin 2023 janë rritur me 100.3%.

Grafiku 2: Shpenzime të Turistëve të Huaj në Shqipëri në milionë euro, 2008-Q1 2024




Burimi: Banka e Shqipërisë

SHPENZIMET E SHQIPTARËVE SI TURISTË JASHTË VENDIT

Nga vlerësimet e Bankës së Shqipërisë, rezulton që shqiptarët si Turistë jashtë vendit kanë shpenzuar 2.34 milionë euro në vitin 2023, ose 32% më shumë sesa në vitin 2022. Rritja më e madhe e shpenzimeve të shqiptarëve që kanë vizituar vendet e tjera si turistë, krahasuar me vitin paraardhës është viti 2022, në të cilin është shënuar rritje me 65%.

Grafiku 3: Shpenzimet e Shqiptarëve si Turistë jashtë vendit në milionë euro, 2008-Q1 2024




Burimi: Banka e Shqipërisë

TË ARDHURAT NETO NGA TURIZMI

Për të shikuar të ardhurat reale të përfituara nga Turizmi kemi gjetur diferencën e shpenzimeve që bëjnë turistët e huaj në vend me shpenzimet e bëra nga shqiptarët jashtë vendit si turistë. Pra, në këtë mënyrë mund të shikojmë se sa janë të ardhurat neto të realizuara në Shqipëri si shkak i turizmit. Rezulton që në tre vitet e fundit të ardhurat nga turizmi janë rritur proporcionalisht pozitivisht në krahasim me periudhën e mëparshme. Pika më e lartë e të ardhurave neto rezulton në vitin 2023, me 1.84 milionë euro neto, që është rreth 72% më shumë sesa në vitin 2022. Mbi 1 milionë euro të ardhura neto nga Turizmi kanë rezultuar edhe në vitin 2022, përkatësisht 1.07 milionë euro.

Grafiku 4: Shpenzimet neto të Turistëve të huaj brenda vendit me Turistët vendas jashtë, në milionë euro, 2008-Q1 2024




Burimi: Banka e Shqipërisë

NETË QËNDRIMET NË SHQIPËRI NGA JO-REZIDENTËT

Një nga problemet e vazhdueshme në Shqipëri për shkak të të ardhurave të ulëta janë edhe netë-qëndrimet e pakta ndër vite në strukturat akomoduese në vendin tonë. Në vitin 2023 netë-qëndrimet në Strukturat Akomoduese në Shqipëri janë rritur me 54.3% krahasuar me vitin 2022. Përkatësisht, në vitin 2023 netë-qëndrimet sipas INSTAT rezultojnë 3.64 milionë netë. Ky vit shënon edhe pikun më të lartë në

Shqipëri për netë qëndrimet në struktura akomoduese dhe është hera e parë që ka kaluar në shifra mbi 3 milionë, ndërkohë që mbi 2 milionë netë kishte kaluar për herë të parë vetëm në vitin 2022. Në 7 mujorin e parë 2024, situata duket pozitive, për shkak se netë qëndrimet janë 2.44 milionë netë.

Grafiku 5: Netë Qëndrimet në Strukturat Akomoduese shqiptare nga jo-rezidentët




Burimi: INSTAT, përpunime të autorit

NUMRI MESATAR I NETË QËNDRIMEVE NË SHQIPËRI NGA JO-REZIDENTËT

Edhe pse situata e Turistëve dhe të ardhurave që vijnë nga ata është përmirësuar, numri i netë-qëndrimeve mesatare të ulëta për Turistë në Shqipëri ngelet problematike. Numri më i lartë i netë qëndrimeve mesatare për një turist të regjistruar në Struktura Akomoduese është shënuar në vitin 2021, përkatësisht me 2.82 netë për Turistë jo-rezidentë, ndërkohë që pas këtij viti netë-qëndrimet kanë rënë, duke qenë në mesatarisht 2.58 netë gjatë vitit 2023. Niveli më i ulët i netëve mesatare që ka qëndruar një turist në Strukturat Akomoduese është në vitin 2018 me 2.47 netë (matja e netë-qëndrimeve ka filluar në INSTAT në vitin 2018 e në vijim). Për periudhën deri në korrik 2024, situata e netë

qëndrimeve mesatare duket me ecuri më të dobët sesa në vitet e mëparshme. Përkatësisht për 7 mujorin e parë të vitin 2024 një turist (jo-rezident) ka qëndruar në Strukturat Akomoduese mesatarisht 2.19 netë, që është një mesatare më e ulët krahasuar me të gjitha vitet e mëparshme që INSTAT ka të dhëna (Numri mesatar i netë qëndrimeve është llogaritur nga autori si raport i netë qëndrimeve totale dhe numrit të vizitorëve jo-rezident në Shqipëri në Strukturat Akomoduese).

Grafiku 6: Netë Qëndrimet mesatare për jo-rezident në Strukturat Akomoduese në Shqipëri



Burimi: INSTAT, llogaritje të autorit

TURIZMI NË SHQIPËRI SIPAS QËLLIMIT TË UDHËTIMIT


Kur shikojmë qëllimin e udhëtimeve të Turistëve në Shqipëri rezulton që pjesa më e madhe, përkatësisht mbi 90%, 94% për vitin 2023 vijnë për pushime, apo vizitë tek të afërm. Ndërkohë një indikator interesant është i personave që vijnë tranzit, por jo për qëllime turistike të drejtëpërdrejtë, që janë rreth 5% në 2 vitet e fundit. Përkatësisht, në vitin 2023 kanë udhëtuar në Shqipëri për qëllime tranzitore/ditore 485 794 individë, ose 4.8% e totalit të turistëve të regjistruar në Shqipëri.

Për qëllime fetare kanë udhëtuar vetëm 417 individë, që në dukje si indikator duket interesant, duke qenë se kohët e fundit po flitet për të ndërtuar një shtet të ri si kryeqendra e Bektashinjve brenda territorit të

Tiranës. Ndërtimi i këtij shteti do të ishte një potencial për shtuar këtë lloj turizmi, që në vitet e mëparshme duket i papërfillshëm.

Për më tepër, individët që udhëtojnë në Shqipëri për Biznes dhe qëllime profesionale duket sikur po rriten përgjatë viteve të fundit në numër, edhe pse në përqindje për shkak të rritjes së numrit total të turistëve mund të ketë pësuar rënie. Në vitin 2023 shënohen 125 028 individë që kanë udhëtuar në Shqipëri për qëllime profesionale dhe për Biznes.


Grafiku 7: Pjesa e Turistëve të huaj në Shqipëri sipas qëllimit të udhëtimit



Burimi: INSTAT, përpunime të autorit

TURISTËT SIPAS ORIGJINËS

Kur shikojmë numrin e turistëve sipas origjinës rezulton që pjesa më e madhe e tyre janë shqiptarët e Kosovës, që përkatësisht për vitin 2023 përbëjnë 43.3% të totalit të turistëve. Të dytët në rradhë janë turistët që vijnë nga Italia me 9.4%, ndjekur nga Maqedonia e Veriut 7.3%, Greqia 6.6%, Mali i Zi 6.3% e me rradhë. Nga kjo kuptojmë që shumica e individëve që vijnë në Shqipëri janë nga vendet fqinje dhe konkretisht shqiptarë të Kosovës, dhe me probabilitet të lartë shqiptarë nga trevat që ndodhen në vendet fqinje. Mbi 80% e turistëve që vijnë në Shqipëri janë me origjinë vetëm nga 8 vende.


Grafiku 8: Turistë në Shqipëri 2023 sipas vendit të Origjinës

Burimi: INSTAT, pëpunime të autorit

NUMRI I TURISTËVE PËRJASHTUAR VENDET FQINJE

Në rastin kur marrim në shqyrtim vetëm numrin e turistëve nga vendet e tjera dhe përjashtojmë ata që vijnë nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Greqia dhe Italia, rezultojnë që në vitin 2023 kemi pasur numrin më të lartë të turistëve me një rritje me 30% krahasuar me vitin 2022. Përkatesisht, në vitin 2023 në Shqipëri kanë ardhur rreth 636 mijë turistë më shumë në këto vende krahasuar me 2022 duke çuar numrin e turistëve në 2.76 milionë individë.

Grafiku 9: Turistë të Huaj nga vendet jo-fajinje përjashtuar Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë dhe Italinë



Burimi: INSTAT, llogaritur nga autori


SHPENZIME MESATARE PËR TURIST TË HUAJ NË SHQIPËRI

Duke ndërthurur të dhënat që merren nga INSTAT të numrit të Turistëve dhe të dhënat e Bankës së Shqipërisë për të ardhurat nga Turistët në Bilancin e Pagesave, mund të gjejmë sesa shpenzon një turist mesatarisht përgjatë qëndrimit të tij në Shqipëri.

Rezulton që në vitin 2023 një turist në Shqipëri ka shpenzuar rreth 411 euro përgjatë qëndrimit të tij që është përmirësim krahasuar me vitin 2022 me 9.2%. Në vitin 2022 një turist shpenzonte mesatarisht në Shqipëri 376.5 euro. Duke pasur parasysh periudhën e marrë në shqyrtim, 2008 – Q1 2024, viti që ka sjellë turistë më të "pasur" ka qenë viti 2008, vit në të cilin një turist mesatarisht ka shpenzuar 824 euro. Viti i dytë në radhë është viti 2009 me shpenzime mesatare për një turist 701 euro, dhe pastaj viti 2010 me 507 euro. Që pas vitit 2010, shpenzimet mesatare të një turisti kanë pësuar rënie dhe nuk kanë arritur nivelin mbi 400 euro, përpos vitit 2023. Situata duket më pozitive në vitin 2024,

të paktën në tremujorin e parë, ku rezultojn që një turist ka shpenzuar mesatarisht rreth 513.6 euro, duke arritur nivelin e vitit 2010, por duke qenë përsëri larg nivelit të vitit 2009, dhe 2010. Kjo tregon që në Shqipëri ngelet akoma problem që vijnë turist “të varfër” dhe që qëndrojnë për një periudhë të shkurtër siç u tregua më lart.

Grafiku 10: Shpenzimet mesatare të një turisti në Shqipëri përgjatë gjithë qëndrimit të tij



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë, përpunime të autorit


SHPENZIME DITORE MESATARE TË NJË TURISTI TË HUAJ NË SHQIPËRI

Nëse bëjmë një llogaritje të shpenzimeve ditore të një turisti në Shqipëri rezultojn që viti me ecurinë më të lartë, që mund të ketë ardhur për shkak të rritjes së çmimeve është viti 2024, përkatësisht 3 mujori i parë që kemi të dhëna. Duhet të kemi parasysh se llogaritja është bërë në bazë të netë qëndrimeve mesatare për personat që kanë qëndruar në Struktura Akomoduese në Shqipëri si një matës i mirë dhe mesatarizim për të gjithë turistët. Në vitin 2023, rezultojn që një turist ka shpenzuar mesatarisht në ditë 159 euro, ose 12.4% më shumë sesa në vitin 2022. Ndërkohë në tremujorin e parë të vitit 2024, një turist rezultojn

që ka shpenzuar mesatarisht në ditë 262.5 euro. Në këtë periudhë shpenzimet e larta vijnë edhe për shkak se numri mesatar i netë qëndrimeve ka qenë relativisht i ulët (për 3 mujorin e parë 2024 vetëm 1.96 netë).

Krahasimi i shpenzimeve mesatare përgjatë gjithë periudhës së qëndrimit të një turisti me shpenzimet mesatare ditore të tij na tregon që problemi kryesor në Shqipëri me Turizmin lidhet me numrin mesatar të ulët të ditëve që ata qëndrojnë në Shqipëri, sepse Shpenzimet mesatare totale janë relativisht të ulëta, ndërkohë që shpenzimet mesatare ditore janë mbi 100 euro.

Grafiku 11: Shpenzimet mesatare ditore të një turisti në Shqipëri




Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

SHPENZIMET MESATARE TË SHQIPTARËVE SI TURISTË JASHTË VENDIT

Përpos shpenzimeve mesatare që bëjnë turistët e huaj në Shqipëri, duke ndërthurur të dhënat e INSTAT me ato të Bankës së Shqipërisë kemi realizuar edhe shpenzimet mesatare për shqiptarët që shkojnë turist në një vend tjetër. Përkatësisht, rezulton që një shqiptar që ka shkuar turist gjatë vitit 2023, ka shpenzuar mesatarisht përgjatë qëndrimit të tij rreth 338 euro, me një rritje me 12.2% më shumë sesa në vitin 2022. Më pak duket se kanë shpenzuar shqiptarët përgjatë tremujorit të parë të vitit 2024, ku një shqiptar mesatarisht ka shpenzuar si turist jashtë vendit rreth 297 euro.

Duke bërë karahasimin midis turistëve që vijnë në Shqipëri dhe shqiptarëve që shkojnë jashtë si turistë, rezulton që Turistët në Shqipëri shpenzojnë më shumë sesa shqiptarët jashtë vendit.

Grafiku 12: Shpenzime të shqiptarëve jashtë vendit si turistë në euro



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, përpunime të autorit

MODEL EKONOMETRIKO/STATISTIKOR: NDIKIMI I TURIZMIT NË EKONOMI

Për të treguar ndikimin që ka Turizmi në Ekonominë shqiptare kemi realizuar një model ekonometrik. Përkatësisht, jemi ndalur për të shikuar sesa është ndikimi i turizmit në ekonomi.

Për të ndërtuar modelin jemi bazuar në një sërë modelesh tanimë të zhvilluara jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet e tjera. Si fillim nisur nga koeficienti i korrelacionit, rezulton një lidhje e fortë midis dy variablave Prodhimit të Brendshëm Bruto real me numrin e turistëve për periudhën 2002-2023. Përkatësisht, koeficienti i korrelacionit është 0.928, pra që është një vlerë shumë afër numrit 1. Lidhje e fortë dhe pozitive që na jep indicie që këto dy variabla janë të lidhura pozitivisht dhe mund të ndikojnë tek njëra tjetra.

Për të shikuar shkakësinë e një variable nga tjetra kemi realizuar testin Granger Casuality Test, që na tregon nëse një varibël ndikon në tjetrën apo jo si dhe ndikimin e ndërsjellë.

Në rastin kur marrin në shqyrtim logaritmin e dy varibalave kryesore, rezulton që Turizmi ndikon në rritjen ekonomike. (Kjo sepse probabiliteti i testit është 0.0297 që është më i vogël se 0.05 dhe do të thotë që rrëzon hipotezën që ndryshimi i numrit të turistëve nuk e shkakton ndryshimin në PBB). Nga ana tjetër testi Granger i shkakësisë tregon që numri i turistëve nuk ndikohet nga PBB-ja (Probabiliteti 0.2849, më i madh se 0.05, pra nuk e rrëzon hipotezën bazë të jo-shkakësisë).

Sample: 2002 2023

Lags: 4

Null Hypothesis:	Obs	F-Statistic	Prob.
LGTOUR does not Granger Cause LGPBB	18	4.43371	0.0297
LGPBB does not Granger Cause LGTOUR		1.48585	0.2849

Variablat e përdorura kryesisht në studime të ndryshme nga autorë të ndryshëm janë PBB- reale, pra pasi hiqet ndikimi i ndryshimit të çmimeve, numri i turistëve pra mbërritjet e turistëve dhe kursi i këmbimit.

Për këtë arsye, në këtë raport është realizuar një regresion për të dhënë një ide sesa është ndikimi i rritjes së numrit të turistëve në rritjen ekonomike duke përdorur këto variabla.

Regresioni i ndërtuar është si më poshtë, bazuar në artikullin e “College of Business, Southern Taiëan University of Science and Technology, Taiwan”ⁱ, si dhe në artikullin e “Mahmut Zartuk”ⁱⁱ, artikullin e “Yusuf Akan & İbrahim Arslan & Cem İSk”ⁱⁱⁱ.

$$\text{LnPBB} = \beta_0 + \beta_1 \text{LnTour} + \beta_2 \text{ExchRate} + \beta_3 \text{LnPBB}(-1) + u,$$

Ku LnPBB është logaritmi i PBB-së reale të Shqipërisë, LnTour është logaritmi i numrit të turistëve që kanë ardhur në Shqipëri, Exhrate është norma e kursit të këmbimit lekë me euro, duke qenë se shumica e turistëve në Shqipëri vijnë nga Europa. Në konsideratë ndryshe nga punimet e marra në shqyrtim, është marrë edhe lagu i logaritmit të prodhimit të brendshëm. Kjo është bërë për të hequr ndikimin e variablave të tjera që nuk janë marrë në shqyrtim në modelin e zhvilluar, sepse duke marrë një periudhë vonesë të logaritmit të Prodhimit të Brendshëm Bruto heqim ndikimin që ka vetë niveli i PBB-së së mëparshme. Motoda e përdorur është OLS dhe është zhvilluar me E-Views.

Sample (adjusted): 2003 2023
Included observations: 21 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
LGTOUR	0.068711	0.017593	3.905467	0.0011
EXCHRATE	-0.000777	0.000196	-3.963717	0.0010
C	1.708153	0.341930	4.995617	0.0001
LGPBB(-1)	0.666264	0.072182	9.230267	0.0000
R-squared	0.994309	Mean dependent var	6.107962	
Adjusted R-squared	0.993304	S.D. dependent var	0.087586	
S.E. of regression	0.007167	Akaike info criterion	-6.869031	
Sum squared resid	0.000873	Schwarz criterion	-6.670074	
Log likelihood	76.12483	Hannan-Quinn criter.	-6.825852	
F-statistic	989.9966	Durbin-Watson stat	1.646986	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Rezultatet e Regresionit janë treguar në figurën e mësipërme. Tregohet që rritja e numrit të turistëve ndikon pozitivisht në rritjen e PBB-së. Përkatesisht, rritja e numrit të turistëve me 10% do të sillte një rritje me 0.69% ekonominë. Duke bërë një llogari për vitin 2023, rritja e numrit të turistëve me 35% presupozon rreth 2.4 pikë përqindje e rritjes ekonomike të këtij viti ka ardhur si pasojë e turizmit.

Koeficienti është i rëndësishëm statistikiisht sepse p-value është 0.0011 që është më i vogël se 0.05. Modeli i zhvilluar shpjegon 99.4% të varibalës së varur, pra kemi një R2 të barabartë me 0.994. Probabiliteti i F-statistic është shumë afër 0-s kështu që variablat bashkarisht janë të rëndësishme. Kur bëjmë testin e Heteroskedasticitetit p-valie për Chi-Square rezulton 0.2048, kështu që tregon që modeli nuk vuan nga heteroskedasticiteti dhe është i ndërtuar mirë. Testi Reset i mirëspecifikimit të modelit na jep një p-value 0.26, kështu që modeli është i mirëspecifikuar.

Rezultati nga modeli ekonometrik vërtetohet edhe nga artikuj të tjerë të publikuar siç është rasti i publikimit të Selimi, Nasir; Sadiku, Luljeta; Sadiku, Murati^{iv} për vendet e Ballkanit Perëndimor, që vërteton që rritja e turizmit me 1%, do të rriste Prodhimin e Brendshëm Bruto me vetëm 0.08%. Proporcioni i rritjes ekonomike kundrejt rritjes së numrit të turistëve duket që është relativisht i ulët, çfarë na tregon që ndryshimet e mëdha në numrin e turizmit nuk shoqërohen me ndryshime të mëdha në rritjen ekonomike. Për vitin 2024, duhet që të kemi një rritje të numrit të turistëve me 50% ose me 5 milionë persona, në mënyrë që të kemi një rritje ekonomike si pasojë e Turizmit me vetëm 3.45%. Një rritje kaq e madhe e numrit të Turistëve nuk pritet në Shqipëri duke qenë se as kapacitetet e vendit nuk e lejojnë një gjë të tillë në mënyrë të menjëhershme.

Rritja e deritanishme e numrit të Turistëve për periudhën Janar-Gusht 2024 me Janar-Gusht 2023 është në masën 18.7%. Bazuar në rezultatet e modelit të zhvilluar, mund të themi që kjo rritje do të përkthehet në vetëm 1.29% rritje ekonomike. Pra, rritja ekonomike që do të atribuohet Turizmit bazuar në rezultatet e 8 mujorit të parë të 2024, është 1.29%. Kjo na jep idenë që një rritje me shifra të larta e Turistëve përkthehet në vlera të ulëta të rritjes ekonomike. Prandaj, fokusi i Qeverisë Shqiptare, krahas zhvillimit të Turizmit duhet që të jetë në sektorë dhe nënsektorë të tjerë që sjellin një vlerë të shtuar në ekonomi më të lartë.

GJETJET KRYESORE

Turizmi është një nënsektor që ka një kontribut të rëndësishëm në ekonominë shqiptare dhe që po rrit ndikimin e tij çdo vit e më shumë. Duke qenë një nënsektor me rëndësi të madhe ekonomike është bërë pjesë e këtij studimi për të shikuar se sa janë shpenzimet e turistëve në Shqipëri e përkatësisht sa janë të ardhurat që merr Shqipëria sipas raporteve të Bankës së Shqipërisë në Bilancin e Pagesave.

Duke filluar me numrin e turistëve tregohet që numri i tyre është rritur me 35% në vitin 2023, duke arritur për herë të parë në histori në numrin mbi 10 milionë turistë. Ajo çfarë vërejmë kur shikojmë origjinën e turistëve është që pjesa më e madhe dhe përkatësisht mbi 43% e totalit të turistëve për vitin 2023 kanë ardhur nga Kosova. Pra, pothuajse gjysma e turistëve janë shqiptarë të Kosovës që kanë udhëtuar në Shqipëri. Për më tepër, 9.4% të tjera janë turistë nga Italia, 7.3% nga Maqedonia e Veriut, 6.6% nga Greqia dhe 6.3% nga Mali i Zi. Të gjitha këto vende kufitare me Shqipërinë (me Italinë nëpërmjet detit). Në rastin kur marrim numrin e turistëve duke përfshirë vendet fqinje, rezulton që numri për vitin 2023 është 2.76 milionë turistë. Duhet pasur parasysh se ky është një përmirësim apo rritje me 30% nga viti 2022. Pra, jemi në hapa pozitiv të rritjes së numrit të turistëve por që numri përsëri është relativisht më i ulët kur heqim pjesën e vendeve fqinje.

Kur shikojmë qëllimin e ardhjes së Turistëve, rezulton që 94% e tyre janë për udhëtime apo vizita tek familjarët e tyre. Por ajo që bie në sy është që për vitin 2023 4.8% ose 486 mijë persona kanë ardhur vetëm për qëllime tranzitore, pra thjesht kanë kaluar nëpër Shqipëri ose kanë qëndruar një ditë.

Netë qëndrimet mesatare të ulëta në Shqipëri kanë qenë problem dhe duket se do të ngelin edhe për disa vite të tjera për shkak se ecuria tregon që po qëndrojmë në të njëjtat nivele. Përkatësisht, në vitin 2023, një turist jo-rezident ka qëndruar mesatarisht në strukturat akomoduese në Shqipëri 2.58 netë. Për 7 mujorin e parë 2024 netë-qëndrimet kanë

rënë mesatarisht në 2.19 (por kjo për shkak se turistët qëndrojnë më gjatë përgjatë periudhës së verës, kështu që mund të rritet për shkak të Gushtit).

Aspekti më i rëndësishëm që ndikon dhe në ekonomi është se sa para shpenzojnë të huajt në Shqipëri. Sipas Bankës së Shqipërisë, Turistët shpenzuan në vitin 2023 rreth 4.17 milionë euro me një rritje prej 47% krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë Shpenzimet e shqiptarëve jashtë vendit si turistë kanë shpenzuar rreth 2.34 milionë euro duke sjellë të ardhura neto në Shqipëri si pasojë e Turizmit përkatësisht 1.84 milionë euro. Të ardhurat neto nga Turizmi kanë pësuar një rritje me 72% krahasuar me vitin 2022.

Nga llogaritjet rezulton që një turist mesatarisht përgjatë qëndrimit të tij në Shqipëri ka shpenzuar në vitin 2023 rreth 411 euro. Edhe pse me përmirësim nga vitet e kaluara shuma e shpenzimeve ngelet relativisht e vogël sidomos kur krahasohet me vitet para periudhës 2010. Maksimumi i shpenzimeve për turist në Shqipëri (që kur ka të dhëna pas 2008-ës) është shënuar në vitin 2008, kur një turist shpenzonte mesatarisht përgjatë qëndrimit të tij rreth 824 euro. Për 3-mujorin e parë të vitit 2024 situata duket më favorizuese sesa në vitin 2023 për sa i takon shpenzimeve mesatare për turist. Për sa i takon shpenzimeve mesatare që një shqiptar ka bërë përgjatë vitit 2023 si turistë jashtë vendit, shuma është 297 euro përgajtë qëndrimit të tij jashtë.

Në rastin kur shikojmë shpenzimet ditore (matje pas vitit 2018), rezulton që një i huaj në Shqipëri ka shpenzuar mesatarisht rreth 160 euro në ditë. Për vitin 2024, tremujorin e parë situata duket akoma më pozitive me shpenzime mesatare ditore 262.5 euro, por kjo duhet pritur deri në fund të vitit sepse gjërat mund të ndryshojnë për shkak të netëqëndrimeve mesatare të ulëta përgjatë fillimit të vitit.

Kjo tregon që problematika kryesore e Turizmit në Shqipëri lidhet më shumë se sa me turistët “e varfër” me problemin e qëndrimit të shkurtër të tyre në Shqipëri e për pasojë shpenzimet e ulëta që ata kryejnë.

Për të pasur një ide më të qartë të ndikimit të Turizmit në ekonomi, është realizuar një model ekonometrik për të matur këtë ndikim. Rezulton siç pritej që Turizmi ndikon në rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe përkatësisht një rritje me 10% e numrit të Turistëve do të sillte një rritje të PBB-së me 0.69%. Testet e rëndësishme statistikore dhe mirëspecifikimit të modelit tregojnë se modeli i ndërtuar qëndron dhe lidhja e Turizmit dhe me rritjen ekonomike është pozitive. Për vitin 2024, bazuar në të dhënat e 8 mujorit, rezulton që rritja e numrit të turistëve do të kontribuojë në një rritje ekonomike të barabartë me 1.29%, çfarë tregon që një rritje në dukje e lartë e numrit të Turistëve, realisht përkthehet në rritje të ulët ekonomike.

REKOMANDIME

- Problemi kryesor me shpenzimet e ulëta të Turistëve në Shqipëri lidhet me kohë qëndrimit e vogël të tyre në Shqipëri, prandaj duhet të ndërmerren politika të ndryshme në mënyrë që qëndrimi i turistëve në Shqipëri të zgjatet në kohë dhe jo vetëm të rritet numri i tyre. (Paketa turistike me afat më të gjatë)
- Të ndërmerren politika që të diversifikojnë origjinën e turistëve, duke mos pasur turistë të njëjtë nga vendet fqinje çdo vit.
- Të diversifikohen investimet dhe mos të krijohet varësi e lartë nga Turizmi, për shkak të ndikimit që mund të ketë në periudhën afatgjatë. Kjo për arsye se ndikimi i rritjes së numrit të Turistëve përkthehet në një normë të ulët të rritjes ekonomike. Prandaj, duhet pasur qasje e zhvillimit të sektorëve dhe nënsektorëve të tjerë që kanë një vlerë të shtuar në ekonomi më të lartë.
- Të kemi orientim drejt Turizmit të Qëndrueshëm përgjatë gjithë vitit si dhe të gjenden mënyra për zgjatjen e qëndrimit në të gjitha periudhat e vitit.

REFERENCA

i http://science.sdpublishers.org/id/eprint/1393/1/ME_2016032816075535.pdf

ii

https://www.researchgate.net/profile/Mahmut_Zortuk/publication/338697277_ECONOMIC_IMPACT_of_Tourism/links/5e259f1c92851c067e22438f/ECONOMIC-IMPACT-of-Tourism.pdf?origin=journalDetail&_tp=eyJwYWdlIjoiam91cm5hbERldGFpbCJ9

iii https://www.researchgate.net/profile/Cem-Isik-S/publication/228270513_The_Impact_of_Tourism_on_Economic_Growth_The_Case_of_Turkey/links/5481fc140cf25dbd59ea16b4/The-Impact-of-Tourism-on-Economic-Growth-The-Case-of-Turkey.pdf

INSTAT: <https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST>

Banka e Shqipërisë,

https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Seri_Kohore/?evb=agregate&evn=agregate_detaje&cregtab_id=705&periudha_id=3

Fondi Monetar Ndërkombëtar <https://data.imf.org/regular.aspx?key=61545852>

iviv <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/185663/1/v10-i2-p19-25-tourism-economic-growth.pdf>